



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-0/DPK
 Dep. 01-618/14
 Nr. I faq. 02
 Broj stranica
 Nr. pages
 Nr. Prot. 01-618/14
 Br. Prot. Prot No
 Data 20.02.2014
 Datum Date



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.02.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-4300/13, për z. Artan Duraku – Drejtor për Integritet Evropian në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për arsye se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-4300/13, për zyrtarin e lartë z. Artan Duraku – Drejtor për Integritet Evropian në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe njëkohësisht bashkëpronar në biznesin privat “D.P.H. Elzar”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Duraku, fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet dhe me ndryshimet që duhet t'i bëjë për të shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit. Në këtë takim ai ka konfirmuar se në cilësinë e zyrtarit të lartë ushtron funksionin e Drejtorit për Integritet Evropian në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe është bashkëpronar në biznesin privat “Elzar”.

Zyrtari i lartë publik ka kuptuar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik, prandaj pas rekomandimit të Agjencisë, ka premtuar se do të largohet nga pozita e bashkëpronarit nga ky biznes.

Ndërkohë, z. Duraku, ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 538/14) në të cilën vërtetohet se i njëjti është larguar nga pozita e bashkëpronarit në biznesin privat.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatohet se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

